

# community

The New Apostolic Church around the world

02/2015/AI

Takim i apostujve te distrikteve në Zyrh

## Me zemër, shpirt dhe mendje

Të lutesh në emër të  
Jezusit – Shërbesë fetare  
në Dodoma

New Apostolic Church  
International



# Gëzim në Krisht

Të dashur motra e vëllezër të të gjithë botës,

ja ku kaluan edhe disa muaj të vitit 2015. Ata kanë sjellë fat dhe fatkeqësi, dhimbje dhe dëshpërim, gëzim dhe besim. Kur në fillim të vitit ju dhashë lajtmotivin “Gëzim në Krisht”, nuk qe shumë e qartë për mua, se sa komplekse ishte kjo fjalë. Ndoshta dikush ka menduar për fatin e tij këtu në tokë. E kush nuk gëzon me gjithë zemër për këtë? E megjithatë ne duhet të kuptojmë shumë më tepër nga ky lajtmotiv: Gëzim në shërbesa fetare, gëzim nga falja e mëkateve, gëzim në Darkën e Shenjtë. A nuk kemi përjetuar ne të gjithë këto momente të bukura të një bashkimi të gjallë me njëri-tjetrin, a nuk kemi përjetuar inkurajim dhe ndihmë?

Unë jam i bindur se lajtmotivi ynë do të jetojë gjatë. Ai është shumë më tepër sesa një fjali.

Me kënaqësi do të doja t’ju jepja disa mendime të pakta, të cilat e mbështesin, e përforcojnë lajtmotivin e këtij viti „Gëzim në Krisht“:

- Zemra jonë duhet të gëzojë, që ne kemi rreth vetes një bashkim kaq të bukur të fëmijëve të Zotit. Ne jemi pjesë e një bashkësie – Zoti nuk na le të ecim vetëm në rrugën tonë të besimit.
- Zoti Jezus na do dhe vdiq për ne. Neve do të na falen mëkatet dhe ai na thërret në tryezën e tij, me qëllim që të jemi bashkë me të. Në çdo shërbesë fetare ne e përjetojmë atë! Ai vjen në mesin tonë.
- Zoti do të vijë përsëri. Ai na e ka premtuar dhe do ta realizojë këtë. A nuk është ky vallë gëzimi ynë më i madh? Ai vjen për të marrë bashkësinë e tij nuse. Dhe ne mund ta presim atë.



NAK International

Thojeni vetë: A nuk është kjo një gjë e mrekullueshme?

Për këtë gjë gëzojmë të gjithë sëbashku. Unë po ju kujtoj këtu fjalën nga Psalmi 103,2: „Dhe mos harro kurrë, se çfarë të mirash të ka bërë!“

Ju uroj një kohë të gëzuar,

juaji

Jean-Luc Schneider

# | Të lutesh në emër të Jezusit



Foto: NAK Afrika Lindore

Fëmijët i urojnë mirseardhjen apostulit kryesor Schneider dhe Apostujve të tjerë para shërbesës fetare të 19 Prillit 2015 në Dodoma, Tanzania

Gjoni 14,14

*„Në qoftë se do të kërkoni diçka në emrin tim, unë do ta bëj.“*

Të dashur motra e vëllezër, të dashur miq e të ftuar, e djela e sotme është një ditë e veçantë për punën e Zotit këtu në Afrikën Lindore. Të gjithë apostujt e distrikteve të Afrikës janë sot këtu, pasi apostuli juaj i distriktit del në pension dhe vendoset një pausë e ri. Unë jam i sigurt, se kjo do të jetë një ditë vendimtare në historinë e kishës së Afrikës Lindore. Por mos u shqetësoni, do të vendoset vetëm një shërbëtor i ri. Mjeshtri mbetet po ai. Ne të gjithë, qoftë apostul kryesor, apostul distriktit apo apostul i thjeshtë, jemi shërbëtorë të Perëndisë.

Ai është Mjeshtri, Zoti, ne jemi vetëm shërbyes. Edhe apostuli i ri i distriktit është vetëm një shërbëtor i Zotit, ashtu si qe i deritanishmi.

Por unë kam një dëshirë: që secili prej nesh – duke më përfshirë edhe mua – të bëjmë sot një hap të rëndësishëm e vendimtar në rrugën drejt qëllimit tonë të besimit dhe t'i afrohem më pranë Krishtit. Ne duhet të bëjmë një hap të madh drejt tij, t'i ngjasojmë atij dhe të zbatojmë vullnetin e tij.

Teksti që unë sot lexova nga Bibla përmbledh një premtim të mrekullueshëm. Jezusi thotë: „Në qoftë se do të kërkonti diçka në emrin tim, unë do ta bëj.“ Imagjinojeni pak se sa dëshira ka njeriu. A nuk do të kishte qenë thjesht një mrekulli, nëse do t'i luteshe Jezusit dhe ai do t'i përmbushte ato. Por këtë thënie ajo e ka lidhur me disa kushte. Në fillim ne duhet t'i besojmë atij: Ne duhet të besojmë, që ai është Biri i Perëndisë, jo ndonjë farë Çudibërësi apo ndonjë Profet i madh, që na tregon histori të bukura, apo dikush, që na ndihmon në problemet tona. Ne duhet të besojmë, që ai është Biri i Perëndisë, i cili erdhi në këtë botë si një Shpëtimtar, erdhi t'u sillte njerëzve çlirim dhe jetë të përjetëshme. en.

Kushti i dytë është, që ne të lutemi në emrin e tij, pra t'i lutesh në atë mënyrë, sikur ai do të kish bërë për ne, nëse do të kish qenë në vendin

tonë. Nëse ne dëshërojmë përgjigje për lutjen tonë, ato duhet të jenë të tilla, sikurse vetë Jezusi t'i kishte drejtuar, të ishte lutur. T'i lutesh atij në emrin e tij do të thotë: sikur Jezusi t'i kish shprehur vetë ato lutje. Kur njerëzit vinin tek Jezusi me lutje dhe kur për të qe e qartë, se ata nuk e kishin besimin e thellë apo kur ai nuk ishte dakort me lutjen e tyre, vetëm atëherë ai hezitonte t'ua plotësonte lutjen atyre. Një herë erdhën Farisenjtë tek Jezusi dhe kërkuan që ai të tregonte, t'u bënte një shenjë: „Mjeshtër ne duam të

shohim një shenjë nga ti.“ Ai iu përgjigj: „Një brez i mbrapshtë dhe kurorëshkelës kërkon shenjë, por shenjë nuk do t'i jepet, përveç shenjës së Profetit Jona. Sepse ashtu si Jona ishte tri ditë e tri net në barkun e peshkut të madh, kështu edhe Biri i njeriut do të jetë tri ditë e tri net në zemër të tokës“ (Mateu 12,39-40). Kjo qe një përgjigje e qartë.

Ju duhet të besoni tek Ringjallja, shenjë tjetër nuk do të merrni.

Të dashur bashkëbesimtarë, ne duhet të besojmë në Birin e Perëndisë. Ne duhet të besojmë e vetëm të besojmë në Shpëtimtarin tonë, se ai dha jetën e tij për ne. Kjo është edhe dëshmia e dashurisë së tij ndaj nesh. Ne nuk mund t'i drejtohem Zotit çdo mëngjes: „Ah, na jep një shenjë, që ne

Apostuj dhe bishopë në Altar





të dallojmë, se sa e madhe është dashuria jote për ne.“ Kjo nuk do të funksionojë dot. Jezusi e ka dëshmuar dashurinë e tij ndaj nesh shumë më parë: Ai vdiq për ne.

Ne nuk mund të kërkojmë nga Jezusi: „Ah, na jep një shenjë, që ne të dallojmë, se puna që t'i po bën është me të vërtetë punë për çlirim shpirtëror.“ Imagjinojeni, sikur Zoti këtu në Dodoma të kish bërë diçka të mrekullueshme, për të na dëshmuar: Këta janë fëmijët e mi, kjo është puna e Perëndisë. Por ai nuk e bën. Ai thotë: Fëmijët e mi janë dëshmia, se kjo është puna e Zotit, pasi brenda tyre rritet e zhvillohet një Krijesë e re. Po ndodh një lloj Ringjalljeje. Adami i vjetër po vdes dhe një Krijesë e re po zhvillohet dhe po bëhet gjithnjë e më e dukshme. Ne besojmë në punën e Perëndisë, pasi ne shikojmë se si po shpaloset kjo Krijesë e re.

*Kur i lutemi zotit për një besim të fortë, do të na i dhurojë, pasi pikërisht për këtë gjë i lutet ai Atit të tij për ty dhe për mua.*

Jezusi ka dhënë shumë shembuj. Një prej tyre që edhe shëmbëlltyra e groshëve që iu besuan shërbëtorëve. Një princi të një vendi iu desh të largohej nga tokat e tij dhe thirri dhjetë nga shërbëtorët e tij, u dha nga dhjetë grosh (leku i asaj kohe) me kushtin: „Veproni me to, deri sa unë të kthehem përsëri!“ (Luka 19,13). Kur princi u kthye, ai kërkoi llogari. Njëri nga shërbëtorët, ai që e kishte ruajtur groshën e vet me besnikëri, ashtu siç ai ia kish dhënë, përpigj ta argumentonte veprimin e tij duke thënë: „Unë të druham ty (të kam frikë), pasi je një burrë i rreptë“, por Jezusi e tregon qartë, që atij i kishte lënë një detyrë dhe ai duhet ta përmbushte. Ai thjesht duhet t'i ishte bindur zotnisë së tij. Për këtë Jezusi na thotë ne: „Unë jam Biri i Perëndisë, prandaj dhe fjalët e mija nuk do të shuhen kurrë.“

Të shumë janë njerëzit që do t'i luteshin Jezusit me



**Lart majtas:**  
Apostuli i distriktit Shadreck Lubasi në altar gjatë shërbesës fetare

grua para tij: „Kjo grua është kapur në gabim ndërsa po thyente kurorën. Ajo duhet të ndëshkohet“ (Gjoni 8,4). Jezusi hezitoi, pasi mendimet e tija nuk përputheshin me të tyret. Jezusi është Shpëtimtari. Ai kërkon t'i shpëtojë, t'i çlirojë mëkatarët dhe jo t'i ndëshkojë.

kënaqësi: „Ah, a nuk mundesh vallë të ndryshosh atë Ungjillin tënd? Unë kam dyshimet e mia përsa i përket kësaj apo asaj gjëje. Përshtatja disi kohës në të cilën jetojmë, kushteve të vendit tim.“ Por Jezusi nuk e bën këtë. Kush beson se Ai është Biri i Perëndisë e di, se ajo çka ai ka thënë, ka vlerë deri në përjetësi. Ai nuk do ta ndryshojë mesazhin e tij për shkakun tonë. Prandaj nuk kemi përse t'i lutemi aspak për këtë

Ka edhe diçka tjetër rreth së cilës nuk mund t'i lutemi Jezusit, pasi nuk përputhet aspak me mendimet e tij: ne nuk mund t'i lutemi atij që të ndëshkojë mëkatarin. Nxënësit, pasuesit e tij u përpoqën një herë: „O Zot, nëse do ti, ne mund të themi, që të bjerë zjarr nga qielli dhe t'i djegë të gjithë“ (Luka 9,54). Jezusi i përzuri me të drejtë. Të tjerë sollën një

Nuk vlen gjithashtu nëse i lutesh Jezusit që të të bekojë, kur ke një gjysëm zemre apo një zemër jo të fortë, të lëkundur. Ai është Biri i Perëndisë dhe kërkon gjithë zemrën tënde. Në predikimin mbi mal, ai ka thënë, se në fund do të jenë të shumtë ata, të cilët do të trokasnin në portën e mbretërisë hyjnore dhe do të kërkojnë për të hyrë: „Shumë do të më thonë mua atë ditë: Zot, o Zot, a nuk kemi profetizuar shumë në emrin tënd? A nuk kemi dëbuar demonët në emrin tënd? A nuk kemi bërë shumë mrekulli në emrin tënd? Atëhere unë do t'u them atyre: Nuk ju kam njohur kurrë“ (Mateu 7,21-23). Ai e dinte, se zemra juaj qe e ndarë më dysh, edhe pse ju bëtë gjëra të mëdha në emrin e tij.

Ne nuk mund t'i lutemi Jezusit për bekim, kur zemra është e ndarë, kur ne nuk jemi të bindur e të përlulur përpara tij. Ju e dini, se kur kemi ndonjë problem, mund t'i lutemi

Jezusit për të na ndihmuar. Por nuk do ta zgjidhim dot kurrë atë problem, kur mundohemi të gënjejmë. Kjo nuk funksionon. Zoti nuk mund ta bekojë atë, pasi në fund të fundit ti i kërkon atij të bekojë mosbindjen apo mospëruljen tënde. Ne kemi injoruar besëlidhjen, dhe kemi pritur të na ndihmojë dhe bekojë. Kjo nuk ecën kështu.

Shëmbulli i fundit. Kur Jezusi shkante në shtëpinë e Maries dhe Martës, Maria i ulej atij te këmbët dhe e dëgjonte. Marta qe e zënë me punë. Ajo e pyeste Zotin: „O Zot, nuk e shikon që motra ime më len vetëm mua të të shërbej? Thuaji të ngrihet e të më ndihmojë!“ Përgjigja e tij qe: „Maria ka zgjedhur pjesën më të mirë“ (Luka 10,40.43). Ne nuk mund të presim, që Jezusi t'i japë më rëndësi jetës sonë tokësore se sa asaj të përjetshmes. Për Zotin do mbetet gjithnjë jeta e përjetshme shumë më e rëndësishme se sa ajo tokësore. Prandaj nuk ka kuptim t'i lutesh zotit të ndryshojë prioritetet. Ai nuk do ta bëjë kurrë. Pra, siç e shikoni për disa gjëra nuk ka fare kuptim t'i lutesh Jezusit. Ai nuk do të mundë kurrë t'i ndryshojë ato, pasi ato janë rezultat i një mungese të thellë të besimit tonë, dhe ato nuk përputhen me vullnetin e tij. Ai dëshëron që ne të besojmë.

Cfarë mund të këkojmë prej tij? Eshhtë shumë e thjeshtë. Ne

mund t'i kërkojmë atij atë çka ai ka kërkuar vetë prej Atit të tij. Ai i tha Simon Pjetrit: „Unë i jam lutur (Atit) për ty, që besimi yt të mos shterrojë kurrë“ (Luka 22,32). Edhe ne mund të lutemi e të kërkojmë prej Atit tonë që besimi të mos na shuhet kurrë, pavarësisht se çfarë mund të ndodhë, që ne të mund të besojmë edhe pa na dhënë ai ndonjë shenjë, por

*Unë uroj që secili të lutet në bashkësinë e tij: „Le të jemi një, O At, sido që të na vijë në jetë.“*

vetëm nëpërmjet fjalës së tij. Kjo e bën një besim të fortë. Kur ne i lutemi zotit për një besim të fortë, ai do të na e dhurojë atë, pasi pikërisht për këtë gjë i lutet edhe ai Atit të tij për mua e për ty.

Ne mund të lutemi në emrin e Jezusit: „O Zot u

bëftë vullneti yt.“ Unë e di, se nuk është e lehtë, pasi kemi një mendim të gabuar, pra e kuptojmë gabim vullnetin e perëndisë. Ne mendojmë se është vullneti i perëndisë, që ne vuajmë, që sëmuremi, që vdesim. Kjo nuk është e drejtë. Perëndia nuk do kurrë që ne të vuajmë, që të na ndodhin padrejtësi. Perëndia kërkon ama që edhe në këto vuajtje t'i qëndrojmë besnikë atij.

Jezusi e dinte me të vërtetë, se cili ishte vullneti i Atit të tij: „Mua më duhet ta ndjek këtë rrugë, por Zoti do, që t'i mbetem besnik deri në fund.“ Ky qe vullneti i Atit të tij. Kur Jezusi tha: „U bëftë vullneti yt dhe jo i imi“, e dinte mirë, „Ati im nuk do të më shohë të vuaj. Ai dëshëron vetëm që



Apostuli kryesor Jean-Luc Schneider emëron Joseph Ekhuya në detyrën e Apostulit të distriktit; në sfond: apostuli i distriktit Patrick Mkhwanazi (Afrika Juglindore) dhe apostuli i distriktit Michael Deppner (Republika Demokratike e Kongos)



Falenderim për largimin e Apostulit të distriktit; nga e majta në të djathtë: Apostuli i distriktit Nowl Barnes (Cape), Apostuli i distriktit në pension Shadreck Lubasi (Afrika Lindore), apostuli kryesor Jean-Luc Schneider



t'i mbetem i përlurur deri në fund. Ky është vullneti i tij. Ai duhet të zbatohet.“ Dhe kur lutemi të gjithë bashkë: „O At, u bëftë vullneti yt“, do të thotë që unë kam vendosur të qëndroj besnik sido që të jetë. Pastaj do të na ndihmojë neve Jezusi.

Të kërkosh diçka në emër të Jezusit do të thotë gjithashtu, t'i lutesh atij për mëshirën, e pikërisht në atë mënyrë që ai e pret prej nesh. Ai na e ka shpjeguar shumë qartë, se çfarë është e domosdoshme për ta kërkuar këtë mëshirë: të jesh i përlurur, i gatshëm për t'u penduar dhe të falësh tjetrin. Ky është edhe Ungjilli i Krishtit, dhe kur ne e ndjekim këtë e më pas i lutemi Zotit për mëshirë, ai do të na i dhurojë.

Apostuli i vjetër ka thënë madje, që Jezusi flet për ne në qiell dhe i lutet Atit të vet për të na falë: „Kur ne mëkatojmë e kemi një përfaqësues, një zëdhënës tonin para Perëndisë, kemi Jezu Krishtin që është shumë i drejtë“ (1. Gjoni 2,1). Ai është në qiell dhe na përfaqëson ne. Nëse i lutemi atij për mëshirë me përlulësi, të penduar dhe të gatshëm për të falë tjetrin, atëhere do të na i dhurojë. Edhe ai lutet për ne.

Në një rast tjetër, zoti iu lut Atit të tij për unitet ndërmjet apostujve të tij dhe për të gjithë ata, të cilët besojnë tek Ai nëpërmjet tij. Në këtë mënyrë është lutur edhe për ne. Ne jemi ata, të cilët, falë apostujve, besojmë te Jezu Krishti. Dhe ai lutet për unitetin e popullit të tij. unë uroj që secili prej jush të lutet nëpër bashkësi: „O At, le të jemi një, sido që të vijë puna.“ Nëse ne me të vërtetë lutemi për unitetin e bashkësisë, Jezusi do të na i dhurojë, pasi edhe ai lutet po për këtë gjë.

Kur i lutemi Perëndisë: „Shkurtoje kohën dhe eja sa më shpejt“, ai do të na e plotësojë këtë lutje, pasi edhe ai vetë i lutet po për këtë gjë.

Ju e shikoni në këto pesë pika ne lutemi gjithnjë në emër të Jezusit. Ai do të përgjigjet. Ai do të na i përmbushë ato. Kur ne i lutemi atij që të na forcojë besimin tonë, ai do ta bëjë këtë. Kur ne i lutemi atij për të mbetur të përlurur dhe besnikë sido që të vijë puna, ai do ta bëjë. Kur i lutemi për

mëshirë, ai do të na i dhurojë. Por ne duhet të lutemi në emër të tij, pra të pranojmë kushtet e tija.

Kur i lutemi për unitet pasi, e dëshërojmë këtë me gjithë zemër, atëhere ai do të na e dhurojë këtë. Pasi edhe ai e dëshëron, e kërkon këtë gjë. Kur i lutemi të shkurtojë sa më shumë kohën: „Eja sa më shpejt, o Zot!“, ai do të vijë, pasi edhe vetë e dëshëron këtë.

## MENDIME THELBESORE

### Jezusi dëgjon ato lutje, të cilat ai vetë i përcakton.

Lutjet tona duhet të jenë të bazuara mbi besimin tonë te Jezu Krishti dhe duhet të përputhen me vullnetin e tij. Zoti dëgjon lutësin, i cili përpiqet të ketë një besim të fortë, durim gjatë provave në jetë, të ketë mëshirë, unitet dhe që përpiqet të arrijë Ringjalljen e parë.

Me qëllim që lutjet tona të na dëgjohen, ato duhen të bazohen në besimin ndaj Jezusit dhe të drejtohen në emër të tij, kjo do të thotë të përputhen me vullnetin e tij.



# Perëndia i ngop të uriturit

Në udhëtimin e tij të fundit të Azisë, në dhjetor 2014, apostuli kryesor Schneider mbajti një shërbesë fetare edhe te bashkëbesimtarët e bashkësisë së Makatit dhe Manilës. Në Filipine jetojnë rreth 40.000 të krishterë apostolikë të rinj nën kujdesin e apostulit të distriktit Urs Hebeisen si edhe 1500 vëllezërve të tjerë të administratës.

Uria është një sinjal i trupit tonë. Ajo na informon për një mungesë, të cilën e plotësojmë vetëm me marrjen e ushqimit. Në gjuhën biblike, uria shpirtërore simbolizon kërkesën e shpirtit për të marrë ato dhunti të Perëndisë, që i duhen.

Shpirtit tonë i duhet ngushëllimi. Engjëlli e kishte njoftuar Marinë, se do të lindte Birin e Perëndisë, i cili do të sundonte përjesisht. Ajo do ta sillte atë në jetë në një stallë dhe do e vendoste në një grazhd. Për t'i dhënë forcë asaj, Perëndia nuk ju shfaq menjëherë, por i dërgoi barinjët, të cilët i miratuan, i përforcuan asaj premtimin e dhënë. Perëndia na ka bërë fëmijë të tij dhe na ka premtuar, se do të mbretërojmë bashkë me Jezu Krishtin. Megjithatë kjo nuk na mbron nga çdo fatkeqësi. Ai na ngushëllon, duke dërguar shërbëtorët e tij, të cilët na e konfirmojnë premtimin e tij.

## Të rritesh në besim, në mëshirë dhe njohuri.

Ne e kemi të domosdoshme të forcohem në besim. Besimi i vërtetë nuk qëndron vetëm në besimin e vërtetësisë së fjalës, por edhe në zbatimin e saj. Cili prej nesh mund të pretendojë, se vepron gjithnjë kështu? Ne nuk duhet të ngurrojmë t'i themi Zotit: „Unë besoj; ndihmoje mosbesimin tim!“ (Marku 9, 24). Ai din se si e forcon besimin tonë.

Ne kemi nevojë për mëshirë. Kur po zinte peshq, qe e qartë për Pjetrin se ç'distancë e ndante nga Madhëria e tij Jezu (Luka 5, 8). Perëndia është për ne Ati ynë i dashur dhe Jezusi shoku ynë më i mirë. E megjithatë ne nuk duhet të humbasim nga vëmendja jonë Lavdinë dhe Madhësinë e tyre. Ne kemi nevojë për mëshirë, nëse duam t'i afrohem atij! Perëndia nuk i duron dot



Apostuli kryesor Jean-Luc Schneider midis bashkëbesimtarëve

Foto: NAC Filippine

mëndjemëdhenjtë, ndërsa të përlurur i mëshiron (Jakobit 4, 6).

Ne duhet të rritemi akoma në njohuri e mënçuri. Këtë dëshirë duhet ta përfshijmë në lutjet tona dhe ashtu si Maria duhet të gjejmë pak kohë për të reflektuar (Luka 2, 19). Perëndia u jep, u dhuron mënçuri atyre, të cilët i luten për këtë gjë (Jakobit 1, 5).

Shpirti ynë e kërkon bashkimin me Perëndinë. Këtë e përjetojmë në marrjen e Darkës së Shenjtë, nëse pendohemi me gjithë zemër për mëkatet e bëra. Ne e gjejmë këtë bashkim gjithashtu ndër motrat e vëllezërit, përsa kohë jemi të gatshëm të heqim dorë nga paragjykimet tona. Nëse kjo dëshirë e zjarrtë për çlirim, për shpëtim shpirtëror reflektohet në lutjet tona, Perëndia do të na e dëgjojë atë (Luka 18, 7).

## MENDIME THELBESORE

Luka 1,53

**„I mbushi me të mira të uriturit dhe i ktheu duarbosh të pasurit.“**

Perëndia i dëgjon ata, të cilët i luten atij me përlulje që t'i ngushëllojë, t'u forcojë besimin, t'u dhurojë mëshirë dhe mënçuri dhe t'i drejtojë drejt bashkimit të përjetshëm me të.



## PËR VIZITË TE MARTINA NË SANTIAGO, I



Emri im është Martina. Kam lindur në Argjentinë, por që kur mbusha 20 ditë, jetoj në Kili. Tani jam njëmbëdhjetë vjeç dhe jetoj në Santiago të Kilit, kryeqyteti i vendit tim.



Familja ime përbëhet nga mamaja ime Evelina, babai im Karlos dhe motra ime Luciana.

Edhe qeni im Leon, emri i të cilit në Spanjisht do të thotë Luan, është pjesë e familjes sonë. Në kohën time të lirë dëgjoj me gjithë qejf muzikë. Mendoj me vete se si do t'a kërceja atë dhe provoj fustane të ndryshme.

Luciana dhe unë shkojmë në të njëjtën shkollë, Luciana është në klasë të tretë, ndërsa unë në të pestën. Fotoja është marrë në oborrin e shkollës. Atëherë kemi marrë pjesë në një shfaqje me kërcime tradicionale.

Ne shkojmë në kishën qendrore të Kilit. Ajo është ndërtuar që para 100 vjetëve dhe para pak kohësh



është rinovuar.

Bashkësia quhet Marin. Babai im shërben aty si prift, Luciana shkon në shollën e së dielës, ndërsa unë marr pjesë në mësimin e fesë, të cilin e mban gjyshja ime Mili.

Mamaja ime ndihmon në mësimin e fesë dhe unë e ndihmoj atë në zbukurimin e luleve. Mua më pëlqen ta zbukurojmë altarin me lule. Të dielën mbas shërbesës fetare e kalojmë ditën me gjyshërit, hallat, xhaxhallarët dhe kushërirat e mija.



## KILI

Bashkë me familjen festojmë gjithashtu edhe festën e Pavarësisë. Këtu shikoni Lucianën dhe mua përpara pallatit të qeverisë dhe para një flamuri të madh kombëtar. Nga data 18 deri 21 shtator, në Kili festohet me lojra, kërcime dhe shumë gjëra për të ngrënë.



Një ushqim tipik i Kilit është Pastel de Choclo, një byrek misri. Ky është edhe ushqimi im i preferuar. Ai përgatitet me mish të grirë, pulë, ullinj, vezë të ziera fort dhe misër të grirë. Mbi të hidhet pak sheqer për t'i dhënë ngjyrë pas pjekjes. Kur byrekun e bëjnë prindërit e mi, ai shijon veçanërisht mirë.

## Kutia e letrave



**NDONJËHERË JEMI KAQ TË ZHËNJYER NGA TJETRI, SA DO TË DONIM TË LARGOHESHIM PREJ TIJ. JU KENI FOLUR PËR PËRJETIMET TUAJA.**



„Haha sa për të qeshur!“ – „çfarë po flet ajo?“ – tani ndihet e vetmuar dhe shkon te Sofia, te shoqja e ngushtë, e cila nuk do të kishte vepruar kurrë kështu. „Shpejt te Sofia! Qaj!

**Cosima, 10 Jahre, aus Leipzig**

„Mamaja ime më mori me vete në një qendër tregtare, pasi donte të më blinte një çantë. Kur shkuam atje, pamë se ato ishin shumë të shtrenjta. U mërzita shumë dhe u zhgënjeva! Por mamaja më lejoi të blija lapsa me aromë dhe me ngjyra, dhe përsëri u gëzova, u lumturova.“

**Erin, 9 vjeç, nga Perth (Australi)**



„Njëri nga shokët e mi më kish premtuar të më dhuronte diçka, që mua më kish pëlqyer jashtëzakonisht shumë. Por ai nuk ma dha kurrë atë. Nuk doja ta shihja më me sy, kaq i inatosur isha. Por në shërbesën fetare dëgjova me kujdes dhe kuptova, se Perëndia nuk dëshëron që unë të sillem kështu.“

**Luc-Olivier, 12 vjeç, nga Porto-Novo (Benin)**

# Dëshmimi apo pohimi i besimit

Foto: NAK Internacional

Në Shtator 2015 do të dalë në formën e një libri Pyetje dhe Përgjigje, Katekizmi i Kishës Apostolike të Re. Nga 750 pyetje dhe përgjigje community do të na japë disa nga këto – në këtë botim bëhet fjalë për dëshminë e besimit dhe për Trinitetin e Perëndisë.

## Çfarë është një dëshmim i besimit?

Një pohim apo dëshmim i besimit është një përmbledhje e përmbajtjeve thelbësore të teorisë së besimit. Këtë pohim, dëshmim, e pranojnë edhe anëtarë të një komuniteti fetar. E pikërisht nëpërmjet këtij rrëfimi, dëshmimi, dallohet një komunitet fetar nga tjetri.

## Si u krijuan besimet e para të krishtera?

Dëshmimet apo pohimet e para të krishtera do të quhen „dëshmime të kishës së lashtë“. Ato u krijuan apo rrodhën në shekujt e dytë e të katërt mbas Krishtit. Në atë kohë u formuluan teoria e Trinitetit të Perëndisë dhe teoria e qenies së Jezu Krishtit, pra, e natyrës së tij. Kjo ishte bërë e domosdoshme, pasi pati edhe grindje rreth përmbajtjeve të besimit. Për shembull pati mendime, se Jezu Krishti nuk vdiq në kryq dhe se nuk qe ringjallur me të vërtetë. Nëpërmjet këtij pohimi, dëshmimi të besimit njeriu kufizohej, ndahej nga këto herezi, nga këto mësim të gabuara.

## Cilat janë pohimet apo dëshmimet më të rëndësishme, më thelbësore të kishës së lashtë?

Dy nga pohimet apo dëshmimet më të rëndësishme të kishës së lashtë janë dëshmimi apostolik i besimit

(„Apostolikumi“) dhe dëshmimi apo pohimi i Nizea-Konstandinopolit. Apostolikumi u formulua në parimet bazë të tij në shek. e dytë dhe në shek. e katërt u plotësua, u shtua pak. Pohimi apo dëshmimi i Nizea-Konstandinopolit është rezultat i Këshillit të Nizeas (në Vitin 325 pas Krishtit) dhe të Konstandinopol (në vitin 381 pas Krishtit). Në këtë pohim apo dëshmim u caktua mbi të gjitha me shkrim edhe pohimi apo dëshmimi kundrejt Trinitetit të Perëndisë.

*Një Këshill është mbledhja e personaliteteve të larta fetare, të cilët mblidhen së bashku për t'u këshilluar për çështje të rëndësishme të besimit.*

## Çfarë rëndësie kanë për Kishën Apostolike të Re pohimet apo dëshmimet e kishës së lashtë?

Teoria e Kishës Apostolike të Re bazohet tek Shkrimi i Shenjtë. Dëshmimi i besimit të kishës së lashtë përmbledh përmbajtje thelbësore, të cilat dëshmohen edhe në Shkrimin e Shenjtë.

Kisha Apostolike e Re pranon dhe njeh të dy dëshmitë e formuluar të besimit të kishës së lashtë rreth Trinitetit të Perëndisë, rreth Jezu Krishtit si perëndi e vërtetë dhe njeri i vërtetë, pranon lindjen e Jezusit nga virgjëreshë Maria, beson në dërgimin e Shpirtit të Shenjtë, në Kishën, në Shenjtërimet, në prirjen e rikthimit të Krishtit dhe në

ringjalljen e të vdekurve.

Me gjithë ndryshimet e shumta ndërmjet besimeve të veçanta, këto dëshmime prezantojnë një element, i cili i lidh së bashku të gjithë të krishterët me njëri-tjetrin.

*„Konfession“ (fjalë për fjalë: „pohim“) do të thotë „pohim i besimit, antarësim kishtar“. Me fjalën „Konfessionen“ përshkruhen edhe komunitetet e ndryshme besimtare kristiane.*

### **Çfarë është dëshmia apo pohimi i besimit në Kishën Apostolike të Re?**

„Unë besoj në zot, në Atin tim, në të Gjithfuqishmin, në Krijuesin e Qiellit dhe të Tokës.

Unë besoj në Jezu Krisht, në birin e lindur prej zotit, në perëndinë tonë, i cili është ngjizur prej Shpirtit të Shenjtë, është lindur prej virgjëreshës Maria dhe që ka vuajtur prej Pontius Pilatit, që është kryqëzuar, që ka vdekur, që është varrosur, që ka shkuar në mbretërinë e të vdekurve dhe që në ditën e tretë është ringjallur prej vdekjes dhe është ngjitur në Qiell; që ka zënë vend në të djathtë të perëndisë, Atit të gjithfuqishëm dhe prej të cilit do të vijë përsëri.

Unë besoj në Shpirtin e Shenjtë, në kishën e vetme, të shenjtë dhe të përgjithshme apostolike, në bashkësinë e të shenjtëruarve, në faljen e mëkateve, në ringjalljen e të vdekurve dhe në jetën e përjetshme.

Unë besoj se Jezu Krishti e drejton kishën e tij, se ka dërguar dhe dërgon apostujt e tij, deri në ardhjen e vet, me detyrën për t'i mësuar besimtarët, për t'u falë mëkatet në emër të tij dhe për t'i pagëzuar ata me Ujin dhe me Shpirtin e Shenjtë.

Unë besoj që ata që janë parashikuar për të marrë një detyrë, mund ta marrin atë vetëm nga apostujt dhe se ata, me shërbimin e tyre, sjellin vetëm bekim e çlirim shpirtëror nga forca, nga pushteti i Apostulatit.

Unë besoj se Pagëzimi me Ujë është hapi i parë drejt rilindjes së njeriut me Shpirt të Shenjtë dhe se, nëpërmjet këtij akti, i pagëzuari pranohet në bashkësinë e atyre, që besojnë në Jezu Krisht dhe që e pranojnë atë si zotin, si perëndinë e tyre.

Unë besoj se Darka e Shenjtë është vendosur nga vetë perëndia në kujtim të asaj sakrifice të dhënë një herë por e vlefshme përgjithmonë, në kujtim të vuajtjeve dhe vdekjes së Krishtit. Marrja me dinjitet e kësaj Darke të Shenjtë bën që ne të kemi një bashkim të përjetshëm me Jezu Krishtin,

perëndinë tonë. Ajo festohet me bukë, e zënë pa maja, dhe me verë. Ajo duhet shenjëtruar e duhet dhënë apo shpërndarë nga vetë apostuli ose nga vëllezër administrate të autorizuar apo të ngarkuar prej tij.

Unë besoj se ata që kanë marrë pagëzimin me Ujë të Shenjtë, duhet të marrin nga një apostul edhe dhuntinë e Shpirtit të Shenjtë, me qëllim që të përmbushin kushtet për të qenë fëmijë zoti, si dhe për të pasë të drejtën e të paralindurit.

Unë besoj se Jezu Krishti do të vijë përsëri, po ashtu siç edhe u ngjit në qiell dhe që do të marrë drejt vetes të paralindurit, qofshin tashmë të vdekur apo të gjallë, të cilët ishin përgatitur dhe që e prisnin ardhjen e tij; besoj që ai, mbas Martesës në Qiell, do të zbrësë në tokë së bashku me të tijtë, që do të ngrëjë mbretërinë e paqes dhe që do të sundojë me ta si priftërinj mbretërorë. Mbas përfundimit të mbretërisë së paqes, ai do të zhvillojë Gjygin e Fundit. Më pas zoti do të ngrëjë, do të krijojë një Botë të re dhe një Qiell të ri dhe do të banojë midis popullit të tij.

Unë besoj se e ndjej për detyrë t'i bindem pushtetit tokësor, përse kohë ai nuk bie ndesh, nuk kundërshton ligjet hyjnore“.

### **Çfarë rëndësie ka ky pohim apo dëshmim i besimit në Kishën Apostolike të Re?**

Dëshmimi apo pohimi i besimit të Kishës Apostolike të Re sjell, shpreh nëpërmjet dhjetë artikujve të besimit, lidhjen e drejtpërdrejtë me teorinë e Kishës Apostolike të Re. Ai ka për detyrë të skalisë, të formojë edhe qëndrimin e besimit të krishterëve apostolikë.

Përveç kësaj, ky pohim apo dëshmim i besimit shërben për t'ua bërë të njohur edhe njerëzve të tjerë përmbajtjen thelbësore të besimit apostolik të ri.

Musthead

Publikues: Jean-Luc Schneider,

Überlandstrasse 243, CH-8051 Zurich/Sëitserland

Shtëpia botuese Friedrich Bischoff GmbH

Gutleutstraße 298, 60327 Frankfurt a. M.

Editor: Peter Johanning

# Triniteti i Perëndisë

## Kush është kjo Perëndi e përbërë prej tri pjesësh?

Perëndia është një qenie shpirtërore, e përsosur, e krejtësisht e pavarur. Ai është i përhershëm, ai është pa fillim e pa mbarim. Një anë e Perëndisë është Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë. Kur flitet për „Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë“, atëherë nuk kemi parasysh tri Perëndi, porse këta tre persona, që e përbëjnë atë një Perëndi.

## Çfare karakteristikash, tiparesh të Perëndisë njohim ne?

Njerëzit nuk mundën ta përshkruajnë Perëndinë ashtu siç duhet. Por ne njohim tiparet, karakteristikat e tij: Ai është një dhe i vetëm (i vetmi), i Shenjtë, i Plotfuqishëm, i Përrjetshmi, i Dashuri, i Mëshirshmi, i Drejti, i Përsosuri.

## Në çfarë raporti qëndrojnë Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë me njëri-tjetrin?

Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë janë emrat e këtyre tri personave hyjnorë. Edhe pse ato mund të dallohen nga njëri-tjetri, ata janë megjithatë një Perëndi. Në traditën e krishterë, secili prej këtyre personave hyjnorë ka prioritetin e vet: Perëndia, Ati, është krijuesi i Tokës dhe i Qiellit. Perëndia, Biri, u bë Shpëtimtari i njerëzimit, dhe dha edhe jetën e tij që t'u sillte atyre çlirimin shpirtëror. Perëndia, Shpirti i Shenjtë, është Krijuesi i ri: Ai kujdeset, që ky Shpëtim apo çlirim t'u bëhet e mundur njerëzve dhe që Krijesa e re të mund të arrijë përsosmërinë e saj.

## Çfarë do të thotë definicioni „Ati“, kur përdoret i lidhur me definicionin Perëndi?

Kur definicioni, fjala „Ati“ përdoret i lidhur me fjalën Perëndi, aty përfshihen aspekte të ndryshme të Krijimit, të Autoritetit dhe te kujdesit të tij. Zoti është Krijuesi dhe ruajtësi i asaj që ai vetë krijoi. Për këtë arsye i lejohet secilit, pra, mbarë njerëzimit t'i drejtohet atij (Perëndisë), i cili është edhe krijuesi i tij, me fjalën „Ati“.

## Çfarë thotë Krijimi rreth Perëndisë?

Krijimi dhe ligjet e tij dëshmojnë për urtësinë e Perëndisë, për madhësitinë e tij, rreth së cilës nuk arrin as edhe imagjinata e njeriut. Psalmisti brohorit i mrekulluar e plot

admirim: „Qiejtë tregojnë lavdinë e Perëndisë dhe kupa qiellore shpall veprën e duarve të tij“ (Psalmi 19,1).

## Në çfarë periudhe e krijoi botën Perëndia?

Zoti e ka krijuar botën në gjashtë „ditët e krijimit“. Me „ditët e krijimit“ kemi parasysh ditë, kohëzgjatja e të cilave nuk është e përcaktuar. Një „ditë“ në krijimin e Perëndisë nuk mund të llogaritet me kohën që përfshihet në ditën tonën. Tek Zanafilla 2,2 shkruhet: „Ndërkaq, ditën e shtatë, Perëndia mbaroi veprën që kishte kryer dhe në ditën e shtatë u çlodh nga gjithë vepra që kishte kryer.“

„... se për Zotin „një“ ditë është si një mijë vjet, dhe një mijë vjet si një ditë“ (2. Pjetri 3, nga 8).

„Sepse një mijë vjet në sytë e tu janë si dita e djeshme që ka kaluar“ (Psalmi 90,4).

## A është krijimi i Perëndisë vetëm ajo që njeriu mund të perceptojë me shqisat e tij?

Jo, ka edhe një krijim të padukshëm të Perëndisë. Misteret e saj – po ashtu si edhe vetë Perëndia – e kapërcejnë hulumtimin njerëzor. Shkrimi i Shenjtë përmban informacione rreth zonave, veprimeve, gjendjeve dhe qenieve jashtë krijimit material.

## A përfshihet djalli tek ky krijim i padukshëm?

Djali që në fillim njëri prej engjëjve të Perëndisë. si i tillë ai bënte pjesë tek krijimi i padukshëm i Perëndisë. Ky engjëll doli hapur kundra Perëndisë dhe u hodh, u përjashtua me gjithçka pati nga qielli dhe nga bashkimi me Perëndinë, për arsye të mosbindjes, zilisë dhe gënjeshtrove të mëdha të tij

„Pasi vetë Zoti nuk i kurseu engjëjt që mëkatuan, por i hodhi ata ... në ferr“ (2. Pjetri 2,4).

„Ai i ruajti me pranga të përjetshme në errësirë për gjyqin e ditës së madhe, edhe engjëjt që nuk e ruajtën gjendjen e tyre të parë, po e lanë banimin e tyre“ (Judës 6).

## Cila është detyra e engjëllit?

Detyra e engjëllit është t'i lutet Perëndisë dhe ta ndihmojnë

atë për t'i përmbushur detyrat e tij . Dashuria e Perëndisë tregohet ndër të tjera, kur ai le që t'i shërbejnë si engjëjt ashtu edhe njerëzit. Nga Mateu 18,10 mësojmë që fëmijët kanë një mbrojtje të veçantë të engjëjve

*„Unë jam Rafaeli, një prej shtatë engjëjve, të cilët qëndrojnë përpara Zotit. [...] Sepse që vullneti i Perëndisë që e bëri të mundur, që unë të kem qenë tek ju; për këtë lëvdoni e adhuroni atë!“ (Tobias 12,15.18).*

*„Ruhuni se mos përbuzni ndonjë nga këta të vegjël, sepse unë po ju them se engjëjt e tyre në qiej shohin vazhdimisht fytyrën e Atit tim, që është në qiej“ (Mateu 18,10).*

### **A duhet t'i lutemi engjëjve?**

Jo, engjëjt janë gjithnjë aktivë sipas vullnetit të Perëndisë: Për këtë nuk u takon atyre falenderimi apo nderimi, porse vetëm Perëndisë.

*Engjëjt janë „të gjithë frymëra shërbenjës, që dërgohen për të shërbyer për të mirën e atyre që kanë për të trashëguar shpëtimin“ (Hebrenjve 1,14).*

### **Përse duhet të merret njeriu me të padukshmen?**

Njeriu është një bashkim i frymës, shpirtit dhe trupit (1. Tessalonikasve 5,23). Trupi është i vdekshëm, pra i përket Krijimit të dukshëm të Perëndisë. Fryma dhe shpirti janë të pavdekshme, i përkasin pra Krijimit të padukshëm të Tij. Me qenë se fryma dhe shpirti ekzistojnë edhe pas vdekjes, është e rëndësishme të merresh disi më shumë me të padukshmen. Qëndrimi që njeriu mban ndaj Zotit në këtë botë, do të ketë veprim, efekt mbi të qënurit në botën e përtejme. Kjo njohuri mund të ndihmojë që t'i bëjmë ballë tundimeve të djallit dhe të bëjmë një jetë që i pëlqen Zotit. Rëndësinë e të padukshmes në jetën tonë na e bën më të qartë Apostul Pali: „Trishtimi ynë është i lehtë dhe kalimtar, por prodhon për ne një peshë të pamasë e të pashoqe lavdie, që ne të mos i drejtojmë syte drejt asaj që shihet (drejt gjërave të dukshme), por ndaj gjërave që nuk shihen (te padukshmes). Pasi gjërat që duken janë për një kohë, ndërsa ato që nuk shihen janë të përjetshme“ (2. Korintasve 4,17.18). Kështu marrja me të padukshmen ndihmon në klasifikimin sa më mirë të gjithçkaje që na godet, që na ndodh në jetë.

## **Në Shtator 2015 si libër**

Parashikohet që më 1 Shtator 2015 do të dalë në një variant të ri Katekizmi i Kishës Apostolike të Re. Këtë e vendosi mbledhja e apostujve të distrikteve (MAD) gjatë takimit të fundit. Vepra është ripunuar në formën e „Pyetje dhe Përgjigje“.

Ka përfunduar edhe përkthimi në pesë gjuhët kryesore si dhe Layout (faqosja). Tashmë po i jepet edhe dora e fundit para shtypit.

### **Nisje e përbashkët në shumë gjuhë**

Në të vërtetë „Katekizmi në pyetje dhe Përgjigje“ (KNK PP) mund të kishte dalë hap pas hapi në anglisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht dhe Portugalisht. Megjithatë kjo mbledhje vendosi, që këto variante të gjuhëve të huaja të shpërndareshin dhe të fillonin në një datë të caktuar. Me këtë datë fillon edhe nisja, starti për gjuhët e tjera, përkthimi i të cilave tashmë është kryer. Këtu përfshihen para së gjithash një rresht prej gjuhëve rajonale të Republikës Demokratike të Kongos, ku jetojnë një e treta e anëtarëve të kishës të gjithë botës.

### **I gatshëm si material mësimor**

Për drejtuesit e kishës që shumë e rëndësishme, për të përpunuar një përmbledhje të këtij Katekizmi, i cili në rradhë të parë është i përshtatshëm për qëllime mësimore. Për këtë, teksti i Katekizmit u nda në 750 pyetje dhe përgjigje. Këtë shpjegoi edhe projekt grupi „Besimi apostolik i ri“ (PG BA), i cili punoi gati dhjetë vjet për këtë vepër bazë.

Skema në formën pyetje dhe përgjigje është përdorur, ka zënë vend në Katekizmet e krishtera që prej shekujsh dhe ka një traditë të gjatë edhe në Kishën Apostolike të Re. Ajo metodë didaktike e fshehur në të është testuar shumë herë. Kështu që (KNK PP) mund të shërbejë më vonë në shkollimin e vëllezërve të administratës dhe si vepër mësimore shoqëruese për fëmijët dhe për të rinjtë.

# | Të reja nga Shqipëria



Apostuli Otten dhe Evangjelisti Elezi në dhomën e vëllezërve

## Udhëtimi i Apostulit tonë Otten në Shqipëri

Si gjithnjë edhe këtë herë shkuam më 16 Qershor të pritnim Apostulin tonë Otten. Ai na përshëndeti duke buzëqeshur dhe u interesua për shëndetin e vëllezërve të admin si dhe për të gjithë motrat dhe vëll e Shqipërisë.

Menjëherë ia nisi punës për të bërë ndryshimet e drejtimit të kishës edhe në administratën shtetërore. Të nesërmen doli me vëllat Fatmirin për të parë objektin për një kopësht të ri fëmijësh. U ndje interesimi i tij edhe ne një takim në Kuçovë për blerjen apo marrjen me qera nga bashkia të një toke për kishë dhe për kopësht fëmijësh. Takime të shkurtra por me rezultate të mëdha (vendi i fjetjes dhe i ngrënies) në përgatitje të ardhjes së Apostulit kryesor Schneider në Shqipëri në 9 dhe 10 Korrik 2016. Për atë diçka normale, për ne Shqiptarët diçka e çuditshme, pasi ardhja e apostulit kryesor do edhe një vit.

## Shërbesa fetare në Elbasan më 21.06.2015

Ditët e para kaluan dhe po afronte dita e dielë. Apostuli dëshëronte të vizitonte këtë rradhë bashkësinë e Elbasanit si dhe atë të Lushnjes, pasi nuk e kishte parë sallën e shërbesës fetare, që ai u bëri dhuratë fëmijëve të zotit të këtij qyteti.

Në orën 8:30 u nisëm për në Elbasan. Apostulin e shoqëroi Ev. Fatmiri, gruaja e tij Marjana dhe motër Natasha. Ne kishën e bukur të Elbasanit kishte dalë si gjithnjë Bariu i palodhur, me gjithëse tashmë në pension, Hysni Agolli. Fjalët e tij përshëndetëse e prekën shumë apostulin.

Ai e falenderoi Bariun për punën e tij të palodhur që ai akoma vazhdon të bëjë për kishën dhe bashkësinë.



Fëmija reciton



U futëm në dhomën e vëllezërve ndërsa motrat e vëllezërit e Elbasanit po vinin një e nga një. Ishin mbledhur rreth 29. Grupit të fëmijëve të zotit do t'i shtoheshin këtë herë edhe tre anëtarë të rinj, familja Guga. Një çift i ri me djalin e saj. Ata kanë disa kohë që e ndjekin shërbesën tonë fetare, kanë sjellë me vete miq e shokë të tyre dhe janë të kënaqur me motrat e vëllezërit elbasanas. Edhe ata ishin përgatitur për këtë ditë. Kishin pastruar vullnetarisht oborrin e kishës, kishin lyer me të bardhë të gjithë murin rrethues, e të gjitha këto me rastin e ardhjes së apostulit dhe marrjes së Vulës së Shenjtë.

Këtë të dielë apostuli shërbeu me fjalën e marrë nga 1 Korintasit 10.13 ku thuhet: “Asnjë provë, tundim nuk ju ka

Apostuli Otten dhe familja që sapo mori Vulën e Shenjtë



Foto: NAK Shqipëri

Bashkësia e Elbasanit



Foto: NAK Shqipëri

vogël si dhe një tjetër kishte përgatitur diçka në gjermanisht. Motrat dhe vëllezërit elbasanas përgëzuan përzemërsisht familjen Guga, këtë treshe të re të fëmijëve të zotit, duke marrë edhe qerasjen që ata kishin përgatitur për të gjithë pjesëmarrësit. Para se të ndaheshim bëmë edhe një foto të përbashkët.

gjetur juve, përveç se tundimi njerëzor, por Perëndia është besnik dhe nuk do të lejojë që t'ju tundojnë apo provojnë përtej fuqive tuaja, por së bashku me tundimin do t'ju japë edhe një rrugëdalje, që ju të mund ta përballoni”. Motrat dhe vëllezërit dëgjuan me vëmendje fjalën e apostulit. Mbas faljes së mëkateve dhe para marrjes së Darkës së Shenjtë, morën vulën e Shenjtë çifti me djalin e tyre.

Në fund të shërbesës fetare luajti në violinë një vajzë e

# Të reja nga Shqipëria



Foto: NAK Shqipëri

Apostuli Otten, kryeplak Rafaeli dhe prifti Rrudha

Pa pyetur fare për lodhjen nisemi përsëri rreth orës 16:30, ditën e Dielë për në qytetin e Lushnjes. Krahas grupit që e shoqëroi atë mëngjes, apostulin e priste atje edhe kryeplaku i distriktit Andrea Rafaeli së bashku me të shoqen e tij Elsa si dhe prifti i bashkësisë së Lushnjes Kristaq Rrudha dhe bashkëshortja e tij. Motrat e vëllezërit, rreth 20, u mblodhën dhe e përshëndetën edhe ato apostulin. Në fytyrat e tyre ndjehej gëzimi. Ata kishin jave të tëra që mblidheshin në një sallë të denjë për ta, ndërsa për apostulin që shërbesa e parë në këtë ambient të këndshëm.

Apostuli falenderoi kryeplakun për punën që ai kish bërë dhe për kontributin e tij në rinovimin e mobilimin e sallës si dhe për hapjen e një kopshti pa drekë në një sallë tjetër përballë sallës së kishës.

Në shërbesën e mbasdites apostuli shërbeu me një fjalë të marrë nga 2 Timoteu 1,9 ku shkruhet: “që (Zoti) na shpëtoi dhe na thirri me një thirrje të shenjtë, jo sipas veprave tona, por sipas qëllimit të tij dhe sipas hirit, që na dha në Krishtin Jezus para fillimit të kohëve”.

Në fund të shërbesës, mbas një fotografie të përbashkët përpara ambientit të ri, u larguam të lodhur por me gëzim në zemër, pasi apostuli dhe ne u kishim shërbyer motrave dhe vëllezërve tanë.

## Shërbesa fetare në Lushnje me 21.06.2015 mbasdite



Foto: NAK Shqipëri

Bashkësia e Lushnjës

## Në mbështetje të kopshteve të fëmijëve të Kishës Apostolike të Re në Shqipëri



Foto: NAK Shqipëri

Tre të rinjtë e orkestrës simfonike VRV

**Ditën e Shtunë, më 18 Prill 2015, u bë e mundur t'i jepej një tjetër ndihmë financiare kopshtit të fëmijëve „Dua të rritem“ në zonën e Yzberishtit, Tiranë.**

Mbas koncerteve që dhanë tre të rinjtë Maïke Oster, Philipp Kujath dhe Marcel Sahn të orkestrës simfonike të të rinjve

Prift Lubczyk dhuron për kopshtin e Lushnjes një ndihmë financiare



Foto: NAK Shqipëri

të Kishës Apostolike të Re të Vestfalisë së Rinit Verior në Tetor 2014 në Kishën Apostolike të Re në Fier dhe në Tiranë, iu lindi të treve një ide, për ta përsëritur edhe një herë po këtë koncert në Gjermani. Dhe kështu ndodhi, që në Mars 2015 u mbajt një koncert nga treshja e të rinjve në NAK Herten-Westerholt dhe në NAK Braunschweig. Ashtu sic është bërë zakon në Gjermani nuk shiten bileta për hyrjen, porse në fund të koncertit hidhen lekë në kasë. Ai lek që mblidhet dhurohet dhe kështu këtë herë iu dhurua kopshtit të fëmijëve të Kishës Apostolike të Re në Tiranë.

Në Prill 2015, prifti Jürgen Lubczyk i dorëzoi drejtuesit të kopshtit Fatmir Elezi dhe bashkëshortes së tij Marjana, shumë prej als 1.200 € për të mundësuar rinovimin, zgjerimin e këtij kopshti.

### Ngritja e një kopshti fëmijësh në Lushnje

Të Dielën, më datë 19 Prill 2015, pati mundësi të dorëzohej në prezencë të apostul Franz-Wilhelm Otten edhe kontributi i një fondacioni të papërcaktuar nga Zvicra një shumë prej më shumë se 100.000 Lekë për mobilimin e kopshtit të ri të Kishës Apostolike të Re në Lushnje. Si përfaqësues i këtij kopshti ishte kryeplaku Andrea Rafaeli, i cili mori dhuratën e bërë. Me ato të ardhura financiare do të blihen mobilje të vogla dhe pajisje të tjera si garderoba, tavolina e karrige. Hapja e këtij kopshti do të bëhet në javët që vijojnë.

Kopshti i ri ndodhet në një lagje të mirë, pranë rrugës kryesore në Lushnje dhe është i arritshëm nga cdo anë. Ai është ngjitur me sallën tjetër, e cila përdoret si salla e shërbesave fetare, në katin e parë të një shtëpie private.



Foto: NAK Shqipëri

Prift Lubczyk dhuron për kopshtin në Tiranë një ndihmë financiare

# Vështrim i përgjithshëm

05.07.2015	Saarbrücken (Gjermani)
12.07.2015	Goma (DR Kongo)
13.07.2015	Bukavo (DR Kongo)
17.07.2015	Bandundu Ville (DR Kongo)
19.07.2015	Kinshasa (DR Kongo)
02.08.2015	Danzig (Poloni)
29.08.2015	Vanadzor (Armeni)
30.08.2015	Tiflis (Gjeorgji)
06.09.2015	Villingen (Gjermani)
09.09.2015	Noumwa (Australi)
13.09.2015	Auckland (Australi)
27.09.2015	Düsseldorf (Gjermani)

